



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 164/2 Prot.

Tiranë, më 02 . 02 . 2026

V E N D I M

Nr. 20, datë 02 . 02 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 23 Regj., datë 20.01.2026³, të shtetasit A. P, kundër Shoqërisë “Illyrian Guard” sha, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, A. P, pranë KMD-së, ndër të tjera, citohet si më poshtë vijon:

“Që prej datës 13.09.2019, kam lidhur marrëdhënien e punës me palën e paditur, Shoqërinë “Illyrian Guard” sha, në pozicionin e punonjësit të shërbimit/Roje, formalizur nëpërmjet kontratës individuale të punës. Marrëdhënia e punësimit ka vijuar normalisht për palët dhe kam bërë shërbim gjithmonë

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Plotësuar nga subjekti ankues nëpërmjet e-mailit datë 26.01.2026.

pranë objektit të Autoriteti të Aviacionit Civil, duke qenë punonjës prej më shumë se 5.7 vitesh në këtë objekt.

Ju vë në dijeni se ndaj meje personalisht ka filluar një persekutim me karakter ndëshkëmor, nëpërmjet kërcënimeve telefonike dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues në kontekstin e moralit dhe dinjitetit në vendin e punës.

Më datë 14.12.2024, ka filluar dhuna nga përgjegjësi i shërbimeve të zonës nr. 6, z. L. Xh, me thirrje dhe mesazhe kërcënuese për transferime të vazhdueshme, si dhe për takime me detyrim jashtë orarit të punës, edhe pse e kam bërë me dije që kam dy fëmijë të mitur për të cilët duhet të kujdesem se bashkëjetuesja ime është e vetëpunësuar.

Më pas, për këtë përndjekje kërcënuese me heqje nga puna dhe transferime të paligjshme, të cilat janë bërë traditë në Shoqërinë “Illyrian Guard”, i jam drejtuar në mënyrë të vazhdueshme përgjegjësit të shërbimeve të qarkut Tiranë, z. E. Sh, për sjelljen abuzive të z. L. Xh. Edhe pse në mënyrë sistematike e kam vënë në dijeni për sjelljen e pahijshme, nuk janë marrë masa ndaj tij. Ky i fundit ka vazhduar në të njëjtën mënyrë, edhe pse në mënyrë të përsëritur e kam informuar për shkeljet ligjore që kryente në raport me mua si punonjës.

- Lidhur me qëndrimin dhe trajtimin denigrues, çnjerëzor dhe poshtërues të z. L. Xh ndaj meje:

Më datë 14.12.2024, ditë në të cilën isha i planifikuar për turnin e parë në shërbim, që fillon në orën 07:00 të mëngjesit, rreth orës 06:00 nuk isha në gjendje të mirë shëndetësore, dhe për këtë arsye u vizitova dhe u pajisa me raport mjekësor, për datat 14 dhe 15 dhjetor 2024. Për shkak të kësaj situate nuk isha në gjendje të paraqitesha në punë atë mëngjes dhe rreth orës 09:30 telefonova përgjegjësin e shërbimit, z. L. Xh, për ta informuar për pamundësinë time. Ai përmes një sms në WhatsApp më njoftoi se më kishte zëvendësuar me një koleg të turnit të dytë dhe më kishte transferuar në një vendroje tjetër.

Pasi u lidha në telefon për t'i shpjeguar situatën dhe i dërgova raportin mjekësor, më ofendoi duke më thënë: “Sytë i ke në ballë, por kokën bosh”.

Në bazë të kontratës së punësimit, në nenin 8 të saj, për raste aksidentesh apo sëmundjesh ne e kemi detyrim të njoftojmë punëdhënësin brenda orës 12:00 të mesditës, megjithatë unë e kam njoftuar në orën 09:30, gjë që vërtetohet përmes materialeve të WhatsApp dhe regjistrimeve të bisedave telefonike. Ky është episodi i parë i dhunës dhe kërcënimeve në lidhje me punën.

Pasi fola me z. L. Xh në telefon dhe i shpjegova se nuk e kisha të mundur të paraqitem në turnin e parë por se mund të shkoja në turnin e dytë, edhe pse isha me raport mjekësor, më tha: “Do ta marrësh vesh”.

Një episod tjetër është gjatë muajvë në vijim kur më ka kërkuar të mënyrë të detyrueshmë të paraqitem në instruktazh, duke kërcënuar në grupin e punës të zonës nr. 6, se kush nuk paraqitet në instruktazh do të merret masë disiplinore.

...çdo punë jashtë orarit kërkon pëlqimin e punëmarrësit, dhe një shkelje tjetër është detyrimi për të punuar pa pëlqimin e punonjësit, pa urdhër me shkrim nga punëdhënësi, pa dokumentim të orëve dhe kompensim financiar.

Pavarësisht se e kam vënë në dijeni në mënyrë të përsëritur, z. L. Xh më ka telefonuar në orare të papërshtatshme për të më kërkuar llogari për mosparaqitje. I njëjti qëndrim i tij është përsëritur edhe në një episod tjetër kur më ka kërkuar të zëvendësoja një punonjës një orë më parë, kur unë isha planifikuar për turnin e dytë në fundjavë.

- Lidhur me situatën me Shefin e Shërbimeve të Qarkut Tiranë, z. E. Sh.

Në mënyrë të vazhdueshme e kam vënë në dijeni se z. L. Xh, mbante qëndrime kërcënuese dhe poshtëruese ndaj meje, por nuk di çfarë masash konkrete janë marrë ndaj tij. E kam njoftuar në mënyrë të përsëritur për shkeljet ligjore që po kryente dhe se do të paraqisja ankesa në organet publike civile, administrative dhe penale, por sërish nuk di çfarë masash janë marrë. Më është siguruar që nuk do të kisha probleme dhe se do të vazhdoja punën normalisht, pa shqetësime.

Më datë 27.03.2025, kam marrë telefonatë nga z. E. Sh, i cili më informoi se dikush nga Salla Operative kishte parë në WhatsApp-in tim që unë kandidoja për deputet nën siglën e subjektit politik “Aleanca Kombëtare Shqiptare”.

Sipas bisedës së regjistruar, më është kërkuar dorëheqja ose largimi vullnetar nga vendi i punës për shkak të kandidimit. I kam shpjeguar që, sipas ligjeve në fuqi, unë jam ende vetëm kandidat dhe jo deputet, duke dhënë dhe shpjegimin përkatës ligjor, sipas të cilit, personi i zgjedhur deputet ka një afat 30 ditor nga momenti kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) konstaton vlefshmërinë e mandatit për të dhënë dorëheqje nga subjekti ku është i pënnësuar.

Të nesërmen menjëherë, më datë 28.03.2025, më është vënë në dispozicion përmes aplikacionit WhatsApp, urdhri i transferimit.

Këtu konstatova se, përveç ndëshkimit, transferimi kishte dhe një kontekst të qartë politik.

..

Pra, e gjithë kjo përndjekje për qëllime ndëshkimore dhe për shkaqe politike në vendin e punës ka zgjatur nga data 14.12.2024 deri më datë 28.03.2025...”

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, “...të hetohet dhe të konfirmohet nëse gjatë marrëdhënies së punës, shtetasi A. P ka pasur trajtim çnjerëzor dhe diskriminim për shkak të bindjeve politike, në dëm të tij, nga përfaqësuesit e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha.”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga pala ankuese, ka rezultuar se:

Pjesë e dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, është dhe kërkesë-padia e datës 15.04.2025, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me paditës: subjektin ankues, z. A. P dhe subjekt të paditur, ish-punëdhënësin, “Illyrian Guard” sha.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në objekt dhe në analizë të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, për shkakun e pretenduar, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak i elaboruar që bëhet prezent në kërkesë-padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në objekt të kërkesë-padisë drejtuar Gjykatës, ankuesi kërkon shprehimisht “Objekti”:

“Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse për dëmin e shkaktuar pasuror dhe jopasuror, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies ë punës në mënyrë të njëanshme, me efekt të menjëhershëm dhe pa shkaqe të justifikuara, nëpërmjet urdhrit abuziv të transferimit dhe të kundërligjshëm me nr. 674/7 prot., dhe nr. 403, datë 28.03.2025, pa marrë pëlqimin e palës paditëse, në mënyrë abuzive, duke shkelur parimin e konsensualitetit dhe të mirëbesimit midis

palëve, shkelje këto të kryera nga pala e paditur me faj të rëndë, me natyrë ndëshkimore dhe për shkaqe diskriminuese, për shkak të bindjeve politike të palës paditëse, me:

- Pagën e një viti pune për zgjidhje të menjëhershme, të pajustificuar të kontratës së punës, për shkaqe ndëshkimore, me kontekst për shkak të bindjeve politike të palës paditëse.
-
- Shpërblimin e dëmit jo pasuror si pasojë e tronditjes psiko-emocionale të palës paditëse për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me efekt të menjëhershëm dhe ...” për shkaqe të pajustificuara nëpërmjet urdhrit të paligjshëm dhe abuziv të transferimit, duke shkaktuar tronditje të marrëdhënieve familjare të palës paditëse me familjarët e tij, për shkak të sjelljes abuzive të palës së paditur me natyrë ndëshkimore dhe kontekst politik.

Në kërkesë-padinë e depozituar para Gjykatës, tek baza ligjore, citohet ndër të tjera dhe Konventa nr. 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Mbi dhunën dhe Ngacimin në Botën e Punës”, Konventa nr. 111 “Mbi Diskriminimin në Fushën e Punësimit dhe Profesionit”.

Gjithashtu, konstatohet se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga subjekti ankues, në cilësinë e paditësit, pranë Gjykatës, ndër të tjera, citohet se:

“...ky transferim është bërë pa asnjë shkak, as pozitiv dhe as negativ. Nuk kam asnjë masë disiplinore në fuqi dhe nuk e kam kryer më parë shërbimin ku jam transferuar.

Në fakt, do të angazhohem për të evidentuar shkakun real të këtij transferimi. Të gjitha rrethanat tregojnë se ky transferim është bërë për shkak të bindjeve të mia politike dhe kandidimit tim për deputet në qarkun e Tiranës.

...

Pasi jam trajtuar në këtë mënyrë, kam vendosur që situata të bëhet publike në media dhe gjithashtu do të paraqes padi në gjykatën civile për trajtim poshtërues me kontekst bindjesh politike.

...2.4 Analizë ligjore në lidhje me shkaqet abuzive të urdhrit të kundraligjshëm të transferimit, si një urdhër i cili përpigjet të fshehtë karakterin ndëshkimor dhe kontekstin e bindjeve politike.

...Kjo situatë bëhet edhe më e rëndë kur urdhri i transferimit vjen në mungesë të çdo arsytimi objektiv apo funksional dhe kur ka indikacione të qarta që vendimi buron nga motive politike apo ndëshkimore. Në raste të tilla kemi të bëjmë me një veprim të kundërligjshëm dhe abuziv nga ana e punëdhënësit.

...

...ndryshimet që bëhen në mënyrë arbitrare apo për motive politike bien në kundërshtim të hapur me dispozitat e Kodit të Punës dhe konsiderohen abuzim me pozitën e punëdhënësit. Në këtë kontekst, urdhri për transferim pa pëlqimin e punëmarrësit shkel një sërë parimesh themelore të së drejtës së punës, duke përfshirë parimin e mirëbesimit, të mbrojtjes së palës më të dobët dhe parimin e barazisë dhe ndalimit të diskriminimit.

..Nëse një urdhër për transferim jepet për qëllime ndëshkuese, me motive politike ose diskriminuese, dhe pa asnjë arsyetim funksional për vendin e ri të punës, atëherë kemi të bëjmë me një situatë ku punëmarrësi ka të drejtë të ndërpresë menjëherë marrëdhënien e punës..

..nëse kjo çështje shkon në Gjykatë, punëmarrësi ka të drejtë të paraqesë një sërë provash për të mbështetur pretendimet e tij, përfshirë mungesën e shkaqeve ligjore dhe funksionale për këtë vendim, si dhe çdo provë që tregon kontekstin politik apo ndëshkues të punëdhënësit. Gjykata, në shqyrtimin e këtij rasti, duhet të analizojë jo vetëm aspektin formal të procedurës, por edhe qëllimin e kontekstin e vendimit. Nëse konstatohet se vendimi ka pasur karakter arbitrar, diskriminues apo politik, Gjykata duhet të shpallë të pavlefshëm urdhrin e transferimit dhe të njohë të drejtën e punëmarrësit për kompensim të plotë për dëmet e shkaktuara, si dhe, nëse kërkohet, të urdhërojë rikthimin në vendin e punës...

...2.5 Konteksti me natyrë penale i shkeljeve të kryera kundrejt punëmarrësit A. P gjatë ushtrimit të detyrës së tij si punonjës privat sigurie, sipas Kodit Penal Shqiptar: nenet 250, 251, 253, 284, etj.

Në rastin kur një punëmarrës ushtron presion psikologjik përmes kërcënimeve, intimidimit dhe presionit për largim ose transferim, mbi një punonjës, për shkak të bindjeve politike, veprimi kualifikohet si një përdorim i dhunës në formën psiko-emocionale. Kjo formë e dhunës, edhe pse nuk rezulton në plagosje fizike, shënon një sulm të drejtpërdrejtë ndaj lirisë personale dhe të drejtave themelore të individit, duke synuar të detyrojë personin të ndryshojë statusin e tij në vendin e punës.

Në kuadrin e Kodit Penal Shqiptar, dispozitat që ndëshkojnë “përdorimin e dhunës” nuk kufizohen vetëm në ato raste ku dhuna është fizike, por përfshijnë edhe ato forma të dhunës që realizohen me mjetet e kërcënimit, intimidimit dhe presionit psikologjik. Kështu, veprimi në fjalë, i cili përfshin presionin për heqje ose transferim për arsye politike, përbën një vepër penale që shkel drejtësinë personale dhe lirinë e mendimit dhe bindjeve, duke u trajtuar nga gjykata si një përdorim i dhunës me përkeqësim, për shkak se motivimi politik shton elementin e diskriminimit dhe abuzimit me pushtetin.

....

Kështu, veprimi në fjalë, sipas interpretimit të dispozitave penale, është një vepër penale e dhunës psiko-emocionale me karakter përkeqësues për arsye politike...

...

Detyra prindërore (me dy fëmijë të mitur) ma vështirëson ndjeshëm përkujdesjen ndaj tyre, duke më zhvendosur në distancë të tejzgjatur nga banesa, ndërkohë që partnerja ime është e punësuar e vetëpunësuar...në këtë kontekst pala e paditur nuk ka marrë në konsideratë nevojat e mia në kuadër të marrëdhënies familjare, por ka synuar të më transferojë me çdo kusht në zonën e spitaleve, pranë Kinostudios ndërkohë që unë banoj në zonën e Astirit.

Ky insistim për një transferim pa motive objektive, por mbi baza ndëshkuese dhe me motive politike, tregon qëllimin e vetëm për të më vështirësuar qëndrimin në punë, në mënyrë që të mos e përballoja

dot procesin e punës dhe të detyrohesha të kërkoja dorëheqjen. Kështu, motivi i fshehur pas urdhrit të transferimit është realisht çnjerëzor.

Orari me turne të para do të bënte të pamundur ndjekjen e aktivitetit tim privat si avokat...

Ky transferim do të më vështirësonte seriozisht marrëdhënien me institucionet dhe gjykatat ku unë ushtroj profesionin si avokat.

Pra, përveçse më prishte organizimin e jetës familjare, më shkaktonte edhe dëme në aspektin profesional. Dhe për këtë arsye, punëdhënësi nuk është shqetësuar aspak, por më ka transferuar më një urdhër të kundraligjshëm, abuziv dhe ndëshkues me kontekst politik. Nuk na është vënë në dispozicion asnjë metodologji e paracaktuar për lëvizjet apo transferimet, por çdo lëvizje është bërë në mënyrë selektive dhe paa asnjë shkak të qartë....

...Nëpërmjet këtij urdhri abuziv, me qëllime ndëshkuese dhe me sfond politik, pala paditur është përpjekur të kryejë veprime që as ligjërish, as logjikisht dhe as funksionalisht nuk qëndrojnë.”

Bazuar në analizën e kërkesë-padisë paraqitur para Gjykatës, ankuesi, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues në marrëdhëniet e punës, lidhur me transferimin e tij, dhe ka kërkuar, ndër të tjera edhe dëmshpërblimin përkatës për zgjidhjen e kontratës së punës me qëllime ndëshkimore, nëpërmjet urdhrit abuziv dhe me kontekst politik; duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Neni 33, pika 7/4, e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”*

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në sa më sipër, si dhe në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 23 Regj., datë 20.01.2026, të z. A. P, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj⁴.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁵, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

⁴ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021; nr. 27, datë 16.02.2021; nr. 77, datë 07.05.2021; nr. 230, datë 25.11.2021; nr. 253, datë 28.12.2021; nr. 77, datë 21.04.2022; nr. 108, datë 20.06.2023; nr. 145, datë 26.07.2023; nr. 89, datë 03.04.2024; nr. 25, datë 30.01.2025; nr. 269, datë 26.11.2025, të Komisionerit.

⁵ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 23 Regj., datë 20.01.2026, të paraqitur nga subjekti ankues, A. P, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA